



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2333/Prot.

7

Tiranë, më 24.01.2024

V E N D I M

Nr. 2, datë 24.01.2024

PËR

***“SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË GRUPIT TË INSPEKTIMIT, NGRITUR ME
AUTORIZIMIN E INSPEKTIMIT NR. 2333 PROT., DATË 20.11.2023, PËR PENALIZIMIN
ME MASË ADMINISTRATIVE ME “GJOBË” TË PROPOZUAR NDAJ SIPËRMARRESIT
TË INSPEKTUAR ALBANIAN FIBER TELECOMMUNICATIONS SH.P.K”***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1.	Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2.	Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3.	Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4.	Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5.	Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 24.01.2024, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullore e Brendshme e ndryshuar “Për Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postar”, miratuar me Vendimin Nr.18 datë 19.12.2023 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të grupit të inspektimit të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- ***“SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË GRUPIT TË INSPEKTIMIT, NGRITUR ME
AUTORIZIMIN E INSPEKTIMIT NR. 2333 PROT., DATË 20.11.2023, PËR
PENALIZIMIN ME MASË ADMINISTRATIVE “GJOBË” TË PROPOZUAR NDAJ***

DAE

[Signatures]

SIPËRMARRESIT TË INSPEKTUAR “ALBANIAN FIBER TELECOMMUNICATIONS” SH.P.K

B A Z A L I G J O R E:

1. Nenit132 e vijues i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (ligji 9918/2008);
2. Neni 46 i ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, (ligji 10433/2011);
3. Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, (ligji nr. 44/2015);
4. Ligji nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, (ligji 10279/2010);
5. Rregullore nr.46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim nr. 2695, datë 27.10.2016;
6. Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacionin shpjegues për shqyrtimin e masës së gjobës së propozuar nga grupi i inspektimit i AKEP të ngritur me Autorizimin e Inspektimit Nr. 2333 Prot., datë 20.11.2023;
2. Projekt akti i formatuar dhe arsyetuar;
3. Autorizimin e Inspektimit Nr. 2333 Prot., datë 20.11.2023;
4. Procesverbalin e Inspektimit Nr. 74, datë 22.12.2023;
5. Dosje e plotë e Procedurës të Inspektimit.



V Ë R E N:

Faktet:

1. Me Autorizimin e Inspektimit Nr. 2333 Prot., datë 20.11.2023, Grupi i Inspektimit ka kryer inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësit të komunikimeve elektronike "Albanian Fiber Telecommunications" Sh.p.k, i regjistruar me AKEP- Nr. 2022-AP-01475, datë 04.08.2022, në Regjistrin e Përgjithshëm të Sipërmarrësve.
2. Objekti i inspektimit konsistoi ndër të tjera edhe me verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara në aktet rregullatore të AKEP.
3. Në përfundim të veprimtarisë inspektuese grupi i inspektimit i AKEP ka hartuar dhe firmosur Procesverbalin e Inspektimit me nr. 74, datë 22.12.2023, sipas të cilit në veprimtarinë e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike "Albanian Fiber Telecommunications" Sh.p.k, janë konstatuar kundërvajtje administrative, për të cilat jepen masa administrative.
4. Rrjedhimisht, Grupi i Inspektimit ka konkluduar për një dënim kryesor, referuar germës a), pikës 1, të nenit 135 të ligjit 9918/2008, duke i propozuar Këshillit Drejtues të AKEP që:
 - a. Sipërmarrësi "Albanian Fiber Telecommunications" Sh.p.k., të dënohet sipas pikës 1, paragrafi III, të nenit 137 të ligjit 9918/2008 me masën administrative "Gjobë" në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë."
5. Nder te tjera, Grupi Inspektimit në Procesverbalin e Inspektimit me Nr. 74, datë 22.12.2023 Gjithashtu, ka vendosur dënimet administrative plotësuese të mëposhtme, duke urdhëruar sipërmarrësin "Albanian Fiber Telecommunications" Sh.p.k :
 - *Të plotësojë menjëherë detyrimi ligjor mbi bllokimin e çdo faqe interneti me përmbytje të paligjshme, apo të dëmshme sipas udhëzimeve të institucioneve ligj zbatuese dhe vendimmarrëse, të bera publike ne faqen zyrtare te AKEP, sipas përcaktimeve të nenit 15 të Ligjit nr. 9918, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
 - *Të raportojë në AKEP të gjitha ndryshimet qe mund te lindin mbi ushtrimin e veprimtarisë sipas parashikimeve të nenit 14 të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";*
 - *Të zbatojë detyrimet ligjore që lidhen me përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të parashikuar në nenin 22 të ligjit 9918/2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Rregulloren Nr. 35, datë 10.07.2015*



“Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publik ”.

6. Përmes shkresës së datës 295 prot., protokolluar në AKEP nr. prot. 2333/1, datë 28.12.2023, sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k ka paraqitur observacionet e veta në lidhje me procesverbalin e inspektimit nr. 74, datë 22.12.2023.
7. Pas njohjes me observacionet me shkrim të sipërmarrësit, “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k, Grupi i Inspektimit, bazuar në nenin 135 të ligjit 9918/2008, i ka paraqitur Këshillit Drejtues më datë 04.01.2024 propozimin e projektvendimit mbi “Shqyrtimin e masës së gjobës të propozuar nga grupi i inspektimit, ngritur me Autorizimin e Inspektimit Nr. 2333 Prot., datë 20.11.2023, ndaj subjektit të inspektuar “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k.
8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga grupi i inspektimit, në veprimtarinë e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k, u konstatuar kundërvajtje administrative, detyrimisht e shoqërueshme sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit sektorial, me masën administrative “Gjobë”.
9. Gjetjet e Grupit të Inspektimit, mbi të cilat janë mbështetur dënimet e mësipërme, janë të parashtruara në mënyrë shteruese në procesverbalin e inspektimit nr. 74, datë 22.12.2023. Faktet relevante për të vlerësuar posaçërisht propozimin e dënimit me gjobë të sipërmarrësit “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k, dhe objekt shqyrtimi nga ana e Këshillit Drejtues, shpjegohen si më poshtë.
10. Nga G.I. pasi u shqyrtua gjithë dokumentacioni i kërkuar gjatë procedurës inspektuese, u krye edhe verifikimi faktik i rrjetit të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k në disa pika të bashkisë Tiranë duke konstatuar se në lokacionin “Rruga e Kavajës”, pranë Kishës Katolike sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k kishte shtruar rrjet kabllor në infrastrukturën e përbashkët nëntokësore ku ndodhej rrjeti në bashkëpronësi të disa sipërmarrësve (përfshirë edhe “Pronet” Sh.p.k).
11. Me shkresën nr. 2222 prot, datë 25.10.2023, AKEP është vënë në dijeni për shqetësimin e disa sipërmarrësve nga vendosja e kabllave në mënyrë të paautorizuar që “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k (Madcom) ka vendosur në infrastrukturën e përbashkët që këta sipërmarrës kanë ndërtuar në zonën 21 Dhjetori - Rruga e Kavajës. (drejt qendrës Tiranë). Në përgjigjen e tij dërguar me shkresën nr. 2222/3 prot, datë 20.11.2023 sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k, sqaron AKEP se:

“Sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k (Madcom) ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrësin “Pronet” Sh.p.k me qëllim bashkëpërdorimin e faciliteteve sipas pjesës së tij takuese të infrastrukturës nëntokësore tubacion dhe kabell FO.

Sipërmarrësi “Pronet” Sh.p.k, ka bashkë investuar në ndërtimin e infrastrukturës nëntokësore tubacion në bashkëpunim me sipërmarrësit e tjerë dhe sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k (Madcom), bazuar në marrëveshjen e lidhur midis Madcom dhe Pronet ka gëzuar të drejtën për të shtruar rrjet kabllor FO, konform të drejtave që ky sipërmarrës ka si bashkë-investues”.

Lidhur me këtë fakt gjatë procedurës inspektuese u administruan nga G.I i AKEP, dy kontrata qiraje të lidhura midis dy sipërmarrësve “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k dhe “Pronet” Sh.p.k (Kontratë qiraje e ndërsjellë dt. 13.10.2023 “Pronet” Sh.p.k, dhe dt. 01.06.2023 “Madcom” Sh.p.k dhe Kontratë qiraje për fibra optike dt. 29.06.2023.

Në relacionin teknik të administruar nga G.I (e-mail 12.12.2023), sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k pohon faktin se në segmentin rrugor 21 Dhjetori - Qendër, sipërmarrësi nuk ka fibër magjistrale por ka një kabëll optic single mode 12 (dymbëdhjetë) fije blerë e porositur me kodin GYFXY-12B, i cili ndodhet në infrastrukturën (puseta) të Bashkisë Tiranë.

Ndërkohë nga verifikimi faktik i grupit të inspektimit në prezencë edhe të përfaqësuesve të subjektit inspektues, por edhe nga verifikimi i kontratës së qeraje së ndërsjellët midis “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k dhe “Pronet” Sh.p.k në zonën e Rrugës së Kavajës rezulton se sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k ka vendosur kabullin e tij në këtë rrjet.

Pra sipërmarrësi në rolin e operatorit përfitues në kundërshtim me parimet dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 35 datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”, ka ndërtuar dhe instaluar pajisje komunikimi në mjedisë private ose publike pa aprovimin për përdorimin e përbashkët të tyre dhe pa një marrëveshje me operatorët e tjerë ekzistues për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës.

Shërbimet e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës duhet të ofrohen në mënyrë që:

- a. Të maksimizojnë përdorimin eficient të rrjeteve të komunikimeve elektronike
- b. Të minimizojnë mundësinë për ndikime negative mjedisore
- c. Të mundësojnë rritjen e konkurrencës në shërbimet e komunikimeve elektronike

Operatori përfitues dhe operatorët e tjerë ekzistues me qëllim arritjen në marrëveshje për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, fillimisht duhet të negociojnë me njëri tjetrin, duke vendosur dhe tarifa të arsyeshme, transparente dhe jo diskriminuese.

12. Në këto kushte, Grupi i Inspektimit ka kualifikuar shkeljen e lartpërmendur kundërvajtje administrative. Rezultati faktik i verifikuar në terren nga GI i AKEP vërteton se sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k ka vepruar në kundërshtim me aktet ligjore e rregullatore.

Referuar Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Rregullore Nr. 35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”, kushti dhe kriteri kryesor për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike mbetet lidhja e **një marrëveshje të përbashkët me të gjithë sipërmarrësit që kanë pronësinë e rrjetit.**

Neni 22 i ligjit 9918/2008 përcakton se:

1. Në rastet kur kërkohet përdorimi ekonomik i hapësirave, planifikimi urban dhe mbrojtja e mjedisit, sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, që kanë të drejtë të ndërtojnë dhe të instalojnë pajisje komunikimi në mjedise private ose publike duhet t'i **ndërtojnë ose instalojnë ato, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre.**
2. Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve janë të detyruar të lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Për sa më lart, pika 1, e paragrafit III të nenit 137 të ligjit 9918/2008 i ndryshuar, parashikon se sipërmarrësi komunikimeve elektronike (person juridik), dënohet me masë administrative “gjobë” për shkeljen e mëposhtme:

- **Nuk ndërton apo krijon rrjete publike të komunikacioneve dhe facilitete shtesë që lidhen me to, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre, sipas pikës 1 të nenit 22 të këtij ligji;**

Bazuar në Rregulloren nr.46, date 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike”, masa administrative ose gjoba për shkeljet e vërtetuara vendosen duke vlerësuar disa kritere.

Bazuar dhe në përmbushje të nenit 135, pika 1, gërma “a” të ligjit 9918/2008, “...kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara:

- i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar”,



Ndërkohë që referuar përcaktimeve ligjore të shprehura në nenin 137, pika 1, paragrafi III-të, grupi i inspektimit ka propozuar penalizmin me masë administrative gjobë në vlerën 10.000.000 (dhjetë milion) lekë për sipërmarrësin “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k .

PROCEDURA PËRPARA KËSHILLIT DREJTUES

13. Në mbledhjen e datës 11.01.2024, Këshilli Drejtues i AKEP-it është njohur me Projektvendimin “Për shqyrtimin e propozimit të grupit të inspektimit, ngritur me autorizimin e inspektimit nr. 2333 Prot., Datë 20.11.2023, për penalizmin me masë administrative “gjobë” të propozuar ndaj sipërmarrësit të inspektuar “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k”.
14. Grupi i Inspektimit relatoi gjetjet faktike, shkeljet ligjore dhe dënimet administrative kryesore dhe plotësuese të vendosura. Grupi i Inspektimit i paraqiti Këshillit Drejtues dokumentet e mëposhtme:
 - Relacionin shpjegues për shqyrtimin e masës së gjobës së propozuar nga grupi i inspektimit të ngritur me Autorizimin e Inspektimit nr. 2333, datë 20.11.2023;
 - Projektaktin e formatuar dhe arsyetuar;
 - Autorizimin e Inspektimit nr. 2333, datë 20.11.2023;
 - Procesverbalin e Inspektimit nr. 74, datë 22.12.2023;
 - Dosje e plotë e Inspektimit.
15. Gjithashtu, Grupi i Inspektimit iu përgjigj pyetjeve dhe kërkesave për sqarime të parashtruara nga anëtarët e Këshillit Drejtues.
16. Këshill Drejtues i AKEP, sipas përcaktimit të nenit 87, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe pikës 4, të nenit 135, të ligjit nr. 9918/2008, vendosi të njoftojë sipërmarrësin “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k për t’u paraqitur në seancë dëgjimore më datë 17.01.2024, për të parashtruar argumentet e veta përpara Këshillit Drejtues të AKEP.
17. Në mbledhje e datës 17.01.2024, ora 11:00, sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k u përfaqësua nga administratori znj. Albarina Lekgegaj si dhe nga z. Ylli Pulaj, të pajisur me autorizimin e përfaqësimit.
18. Përfaqësuesit e sipërmarrësit “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k, përveçse parashtruan me gojë qëndrimin e sipërmarrësit në lidhje me gjetjet e procesverbalit të Grupit të Inspektimit, paraqitën një kopje me shkrim të parashtrimeve, disa dokumente provuese, si edhe autorizimin e përfaqësimit, të administruara rregullisht nga sekretarja e

Këshillit Drejtues të AKEP-it. Pas përfundimit të parashtrimit me gojë, përfaqësuesit e subjektit iu nënshtruan pyetjeve të ngritura nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

19. Këshilli Drejtues u mblodh për shqyrtimin e propozimit për gjobë më datë 24.01.2024.

SHQYRTIMI I PROPOZIMIT PËR GJOBË

20. Këshilli Drejtues, pasi shqyrton rregullshmërinë procedurale të inspektimit, vlerëson nëse përmbushen kushtet për penalizimin me gjobë të sipërmarrësit.

Rregullshmëria procedurale e inspektimit:

21. Sipërmarrësi parashtron se provat e paraqitura nga G.I të materializuar me imazhe në procesverbalin e inspektimit nr. 74, datë 22.12.2023, (konkretisht fotografia Nr.4) nuk është realizuar në prezencë të përfaqësuesve të sipërmarrësit objekt inspektimi.

22. Këshilli Drejtues vëren se neni 37 i ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, (ligji 10433/2011) përcakton se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, inspektori ka të drejtë të hyjë dhe të inspektojë godinat, mjediset, objektet, mjetet e transportit, ku apo nëpërmjet të cilave ushtron veprimtarinë subjekti i inspektimit, si dhe të inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, sendet, substancat, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë, objekt inspektimi.*

Hyrja dhe inspektimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen pa pasur nevojë për lejen e subjektit të inspektuar.

Sipas dispozitave të ligjit 10433/2011 inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka të drejtë të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjedisëve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjedisëve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit;

23. Këshilli Drejtues çmon se administrimi si provë materiale i fotografimeve apo imazheve të mjeteve teknike, të instalimeve apo të rrjetit të sipërmarrësit “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k, qoftë edhe pa prezencë të përfaqësuesve të subjektit të inspektuar konsiderohet veprim procedural i mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.



24. Për këto arsye, Këshilli Drejtues i gjen të pambështetura pretendimet e sipërmarrësit në aspektin procedural.

Shqyrtimi në themel i propozimit për penalizim me gjobë

25. Gjatë shqyrtimit në themel të propozimit për gjobë, Këshilli Drejtues, pikësëpari, vlerëson nëse gjetjet e Grupit të Inspektimit përbëjnë një shkelje të detyrimeve ligjore nga ana e sipërmarrësit. Në vijim, Këshilli Drejtues analizon natyrën dhe shtrirjen e kësaj shkeljeje. Së fundi, Këshilli Drejtues kryen një vlerësim mbi dënimin administrativ adekuat dhe proporcional të shkeljes së konstatuar. Pretendimet dhe argumentet relevante të sipërmarrësit janë grupuar dhe adresohen në seksionet përkatëse të mëposhtme.

• Mbi karakterizimin e shkeljes

Neni 22 i ligjit 9918/2008, përcakton se:

1. *Në rastet kur kërkohet përdorimi ekonomik i hapësirave, planifikimi urban dhe mbrojtja e mjedisit, sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve publike elektronike, që kanë të drejtë të ndërtojnë dhe të instalojnë pajisje komunikimi në mjedise private ose publike duhet t'i ndërtojnë ose instalojnë ato, për të mundësuar përdorimin e përbashkët të tyre.*
 2. *Sipërmarrësit e rrjeteve publike të komunikimeve janë të detyruar të lidhin marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.*
26. Nga më sipër se, kuadri ligjor në fuqi dikton dy detyrime thelbësore për sipërmarrësin kur ai vendos të ndërtoj apo krijoj rrjete publike të komunikacioneve dhe facilitete shtesë që lidhen me to: 1) Sipërmarrësi duhet të mundësoj përdorimin e përbashkët të tyre.
2) Sipërmarrësi i rrjeteve publike të komunikimeve është i detyruar të lidhë marrëveshje për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve në kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 22 të ligjit 9918/2008.
27. Paraprakisht konfirmohet sipas tërësisë së fakteve dhe provave, mbi të gjitha nga relacioni teknik i përcjellë nga vetë sipërmarrësi (edhe me e-mail drejtuar G.I datë 12.12.2023), se në segmentin rrugor 21 Dhjetori - Qendër, sipërmarrësi "Albanian Fiber Telecommunications" Sh.p.k (MADCOM) nuk ka fibër magjistrale por ka një kabëll optic single mode 12 (dymbëdhjetë) fije blerë e porositur me kodin GYFXBY-12B, i cili ndodhet në infrastrukturën (puseta) të Bashkisë Tiranë.

• Mbi natyrën sistematike të shkeljes

28. Këshilli Drejtues vlerëson se shkeljet e dënueshme me gjobë, sipas nenit 137, paragrafi III, të ligjit 9918/2008, karakterizohen nga mos përmbushje të natyrës sistematike, e cila



shkakton asgjësimin ose pengimin në mënyrë domethënëse të synimit të ligjvënësit. Sipas këtij interpretimi, mos përmbushja e detyrimit për mundësimin e përdorimit të përbashkët të rrjeteve të ndërtuara, nuk justifikojnë automatikisht aplikimin e gjobave në shuma tejet të larta të parashikuara veçanërisht në seksionet I deri në IV të nenit 137, paragrafi 1 të ligjit 9918/2008.

29. Rrjedhimisht, shkelja e dënueshme me gjobë rezulton e karakterizuar në rast se provohet se shkelja e atribuar prek tërësinë e interesave të sipërmarrësve të tjerë që operojnë në fushën e komunikimeve elektronike, në kuptim të gëzimit ose ushtrimit të së drejtës së përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve dhe në aspekt të detyrimit për lidhjen e marrëveshjeve për përdorimin e përbashkët të këtyre faciliteteve dhe aseteve në kushtet e kur rrjeti është ndërtuar prej tyre.
30. Këshilli Drejtues pajtohet me sipërmarrësin kur ai shprehet se një ndër mekanizmat që ka parashikuar ligjvënësi për arritjen e qëllimit të veprimtarisë është edhe "Paralajmërimi" si formë dënimi administrativ kryesor. Megjithatë ky dënim, sipas ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, sanksion shkeljet e një rëndësie të vogël të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit ai ka për qëllim evidentimin e tyre dhe paralajmërimin e subjektit që, në rast përsëritjeje të së njëjtës shkelje apo shkeljeve të tjera, jepet një dënim administrativ më i rëndë. Paralajmërimi është "Dënim administrativ", pavarësisht nga emri i parashikuar nga ligji që rregullon një funksion inspektimi.
31. Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, vendoset ai sanksion apo masë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit.

• Mbi dënimin administrativ adekuat dhe proporcional të shkeljes së konstatuar


32. Neni 137, paragrafi 1/1 i ligjit nr. 9918/2008, parasheh se, në vendosjen e gjobave, AKEP merr parasysh:
- a. "rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes;
 - b. rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
 - c. nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
 - d. pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi."
33. Si përfundim në observacionet e paraqitura për procesverbalin e inspektimit kontestimet e përfaqësuesit e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike "Albanian Fiber Telecommunications" Sh.p.k pretendojnë se propozimi i G.I për masën administrative me

gjobë është jo proporcional me cilësimet e dëmit, i bazuar në keqinterpretim të referencave ligjore dhe nuk gjen zbatim në veprimtarinë e “Madcom”.

34. Në këto kushte duke vlerësuar rekomandimet e lëna në procesverbalin e inspektimit, sipërmarrësi merr përsipër të korrigjojë problematikat e konstatuara por kërkon:
- Mos pranimin e propozimit të G.I për masë administrative me gjobë.
 - Dhënien e masës administrative “Paralajmërim”.
35. Lidhur me evidentimin e respektimit ose jo të aspektit procedural nga Grupi i Inspektimit i AKEP, rezulton e evidentuar në procesverbalin e inspektimit se Grupi i Inspektimit i AKEP ka zbatuar plotësisht procedurën e inspektimit sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
36. Lidhur me respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit të grupit të inspektimit në propozimin për marrjen e masës administrative me gjobë ndaj sipërmarrësit objekt inspektimi, mbetet e qartë se marrja e masës administrative me gjobë duhet vlerësuar në kohë dhe duke marr në konsideratë faktin se sipërmarrësi është ri në treg dhe është inspektimi i parë që realizohet.
37. Në vlerësim të përgjithshëm të çështjes objekt shqyrtimi, vlerësohet se sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k nuk ka arritur të dëshmojë apo të bind efektivisht mbi mos përgjegjësisë në kryerjen apo konsumimin e shkeljes ligjore.
38. Në këtë kontekst Këshilli Drejtues vlerëson se sipërmarrësi i inspektuar duhet të planifikojë dhe ndërtojë rrjetet e komunikimeve elektronike publike në mënyrë që të krijojnë sa më pak të jetë e mundur rreziqe dhe shqetësime dhe në mbrojtje të interesit publik dhe të drejtave të të tjerëve.
39. Një ndër mekanizmat që ka parashikuar ligjvënësi për arritjen e qëllimit të veprimtarisë së inspektimit është Paralajmërimi apo këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore si dhe urdhërimin për korrigjim të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre;
40. Prandaj, Këshilli Drejtues vlerëson se dënimi me masa administrative “Paralajmërim” përbën masën adekuate.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në referim të neneve 98 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe neneve 132 e vijues të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 3.8 të Rregullores



Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike”, pasi shqyrtoi propozimin e grupit të inspektimit të AKEP, ngritur me Autorizimin e Inspektimit me Nr. 2333 Prot., datë 20.11.2023,

V E N D O S:

1. Ndryshimin e masës administrative të propozuar nga Grupi i Inspektimit ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k., duke vendosur dhënien e dënimit administrativ kryesor “**Paralajmërim**” në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, ndaj sipërmarrësit “Albanian Fiber Telecommunications” Sh.p.k.
2. Ngarkohet grupi i inspektimit të ngritur me Autorizimin e Inspektimit 2333 Prot., datë 20.11.2023 për hartimin e vendimit përfundimtar të inspektimit sipas këtij vendimi të KD të AKEP.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 (dyzetë e pesë) ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Lorenc Bako

Bleron Dokle

Armer Juka



[Handwritten marks]